



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2619 Prot.

Tiranë, më 02/10 /2025

V E N D I M

Nr. 57, datë 02.10.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE TË MIRATUARA PËR PROGRAMIN
E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT “MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI
FIZIKE” SIPAS PROFILEVE DHE KATEGORIVE, NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 04, datë 21.01.2025 “Një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 06, datë 19.02.2018 ‘Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit’”, i ndryshuar, VKM 41, datë 24.01.2018, pika 2.7, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, neni 18, pika 2, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, mbështetur në propozimin e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, dhe në Relacionin e ardhur nga Drejtoria e Kurrikulave, Senati Akademik në mbledhjen e datës 02.10.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e shpërndarjes së kuotave të miratuara për programin e ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike” ndërmjet dy profileve të tij, profili Inxhinier Fizike dhe profili Fizikan Mjekësor dhe kategorive, pa tejkaluar kapacitetin maksimal pritës për këtë program studimi të miratuar dhe deklaruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.
2. Shpërndarja e kuotave të bëhet sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo



Kuotat e pranimit, për vitin akademik 2025-2026 FIMIF

Nr.	IAL	Njësia kryesore	Programi i studimit	Shuma e kuotave	Kuotat sipas programit të studimit për kandidatët												
					Shqiptarët brenda vendit	Që aplikojnë për program të dytë	Që aplikojnë për transferim studimesh	Të huaj	Me statusin e jetimit	Persona me aftësi të kufizuar	Romë+balkano egjiptian	Trojet					
												Kosovë	RMV	Mal i Zi	Preshevë	Bujanovc	Medvegjë
2	Universiteti Politeknik i Tiranës	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Bachelor në Inxhinierinë Matematike	50	45	0	2	0	1	1	1	0	0	0	0	0	
3			Bachelor në Inxhinierinë Fizike	40	35	0	2	0	1	1	1	0	0	0	0	0	0
4			Bachelor në Inxhinieri Kimike	40	35	0	2	0	1	1	1	0	0	0	0	0	0
5			Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Data Science	30	25	0	2	0	1	1	1	0	0	0	0	0	0
6			Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike	30	20	3	2	0	1	1	1	1	1	0	0	0	0
7			Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë	30	15	8	3	0	1	0	0	2	1	0	0	0	0
8			Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Inxhinier Fizike	14	10	2	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0
9			Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike, profili Fizikan Mjekësor	16	10	4	0	0	0	0	1	1	0	0	0	0	0
9			Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh	30	20	3	2	0	1	1	1	1	1	0	0	0	0
Totali				280	215	20	15	0	7	7	7	5	4	0	0	0	